



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1348 Prot.

Tiranë, më 23 / 09 / 2021

**V E N D I M**

**Nr. 180, Datë 23 / 09 / 2021**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën me nr. 64 Regj., datë 12.04.2021, të subjektit ankues A. L, kundër: Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) Lezhë dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Shkodër, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “*bindjeve politike*”<sup>3</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, A. L, është me profesion mësuese e lëndës matematikë-fizikë prej 29 vitesh, nga të cilat 10 vitet e fundit ushtron këtë profesion pranë shkollës 9-vjeçare “Pashko Vasa”, Shkodër.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD.

<sup>3</sup>Në web-in e KMD-së, tek rubrika e shpjegimit të shkaqeve ( <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>) citohet se: “*Bindja politike*”, shpesh është arsye për trajtim diskriminues dhe përfshin qoftë mbajtjen apo mos mbajtjen e saj, si edhe shprehjen e pikëpamjeve ose anëtarësinë në organizata politike, parti politike”.

Me Urdhrin nr. 23, datë 04.08.2020, të DRAP Lezhë, është shpallur i lirë pozicioni i drejtorit të kësaj shkolle, sipas procedurave të konkurimit për këtë pozicion.

Nëpërmjet Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 *“Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar”*, të MASR dhe Urdhrit të nxjerrë nga DRAP Lezhë, është parashikuar procedura që duhet ndjekur, mënyra e vlerësimit të kandidatëve dhe afatet e shpalljes së fituesit.

Mbështetur në parashtrimet e sjella pranë KMD-së, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur ankesës, rezulton se, subjekti ankues, ka aplikuar për pozicionin e drejtorit në shkollën 9-vjeçare “Pashko Vasa”, Shkodër.

Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor pranë Shkollës sipërcituar, ka njoftuar nëpërmjet e-mailit kandidatët konkurent, se më datë 28.01.2020 kishte përfunduar shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur prej tyre. Në listën e kandidatëve të kualifikuar rezultojnë:

1. A. L (subjekti ankues), vlerësuar me 85.5 pikë.
2. E. Rr., vlerësuar me 101.5 pikë.
3. L. M, vlerësuar me 91 pikë.
4. M. Q, vlerësuar me 63 pikë.

Kandidatët janë njoftuar të paraqiten pranë ZVAP Shkodër, me datë 01.02.2021, ora 10:00 për të realizuar intervistën e stukturuar.

Vlerësimi i kandidatëve sipas Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve (Komisioni), pas intervistës, është si më poshtë:

1. A. L (subjekti ankues), vlerësuar me 9.8 pikë.
2. E. Rr., vlerësuar me 4.6 pikë.
3. L. M, vlerësuar me 9.6 pikë.
4. M. Q, vlerësuar me 8.6 pikë.

Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve, sipas përlllogaritjes së pikëzimit të bërë nga Komisioni, është:

1. E. Rr., vlerësuar me 105.6 pikë.
2. L. M, vlerësuar me 100.6 pikë.
3. A. L (subjekti ankues), vlerësuar me 95.3 pikë.
4. M. Q, vlerësuar me 71.6 pikë.

Sikurse shihet, ankuesja është renditur e treta në pikëzimin e bërë nga Komisioni, gjë të cilën e ka kundërshtuar: pranë Komisionit, ZVAP Shkodër, DRAP Lezhë, DPAP<sup>4</sup> dhe MASR<sup>5</sup>, duke argumentuar se, vlerësimi është i pasaktë dhe në shkelje të procedurës së parashikuar në Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020 *“Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar”*.

---

<sup>4</sup> Akronim për institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

<sup>5</sup> Akronim për institucionin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Referuar Udhëzimit sipërcituar, Shtojcës 5 të tij, parashikohet se pikët maksimale që mund të fitohen nga kandidati, nga shqyrtimi i dosjes është maksimumi 30 pikë, dhe pikët maksimale që mund të fitohen nga intervista e strukturuar janë 10. Në përfundim të përlllogaritjeve, rezulton që maksimumi i pikëve që mund të fitohen nga një kandidat është 40 pikë në total.

Në këtë kontekst, bazuar në përlllogaritjen që Komisioni u ka bërë kandidatëve, ankuesja pretendon se nuk është zbatuar procedura e përcaktuar në Udhëzimin më lart, gjë që ka passjellë pikëzim më të ulët të saj, pasi pesëfishimi që i është bërë pikëve të dosjeve të aplikantëve ka thelluar diferencën (psh. një kandidat duke patur një pikë më shumë në dokumentacion, kur pesëfishohet ka 5 pikë më shumë, ndërkohë që për intervistën është ndjekur standard tjetër (ai që përcaktohet në Udhëzimin përkatës), duke bërë që në përfundim të përlllogaritjes rezultati të dalë i deformuar dhe jo i saktë.

Ankuesja ka pretenduar se një përlllogaritje e tillë nga Komisioni është e qëllimshme, për të favorizuar kandidaten E. Rr, e cila në përfundim të procedurës u shpall fituese, për faktin se ajo është aktiviste dhe mbështetëse e subjektit politik Partia Socialiste, faktuar me daljet haptaz në përkrahje të PS edhe gjatë fushatës aktuale për zgjedhjet parlamentare të 25 prillit 2021. *(nëpërmjet fotove të marra nga rrjeti social Facebook, ku rezulton se ka qenë pjesëmarrëse<sup>6</sup> në aktivitetet politike të PS).*

Po kështu, ankuesja ka pretenduar se edhe drejtuesit e ZVAP Shkodër dhe DRAP Lezhë janë pjesë e strukturave të PS<sup>7</sup> dhe kjo është arsyeja që kandidatja E. Rr, është favorizuar prej tyre për t'u zgjedhur drejtore e shkollës 9-vjeçare “Pasho Vasa” Shkodër, në ndryshim nga ajo që nuk ka asnjë aktivizim politik dhe nuk ka përkrahur asnjë forcë politike, gjë e cila, sipas saj, e ka penalizuar në këtë procedurë konkurimi.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e DRAP Lezhë dhe ZVAP Shkodër, për shkakun e pretenduar prej saj, si dhe ndreqjen e pasojave të shkaktuara si pasojë e tij.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin,

---

<sup>6</sup> Referuar fotove të publikura në rrjetin social facebook.

<sup>7</sup> Ka cituar pjesëmarrjen dhe prononcimet e tyre publike në krah të PS dhe ka bashkëlidhur foto të tyre në aktivitete politike të PS.

*gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Subjekti ankues legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 33, pikat 1 dhe 3, të LMD-së, si dhe legjitimohet *ratione tempore*, në kuptim të pikës 4, germa dh, të nenit sipërcituar.

Ankuesja gjithashtu, legjitimohet *ratione materiae*, pasi pretendimet e saj *prima facie*, janë të tilla që bëjnë pjesë në kompetencat që ligji, i njej Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për shqyrtimin e ankesës në kuptim të nenit 32, pika 1, germa a, të LMD-së, si dhe ka provuar interesin e saj të drejtëpërdrejtë përsa i takon pretendimit për cënim të parimit të barazisë e mosdiskriminimit.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD dhe që lidhen me pretendimin e ankueses për diskriminim gjatë procedurës së ndjekur për emërimin në pozicionin e drejtorit të shkollës 9-vjeçare “Pashko Vasa”, Shkodër.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet me nr. 616/1 prot., datë 16.04.2021 Komisioneri i ka kërkuar informacion dhe dokumentacion në cilësi prove, DRAP Lezhës dhe ZVAP Shkodër, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

Në përgjigje të kërkesës së Komisionerit, ZVAP Shkodër nëpërmjet shkresës me nr. 769/1 prot., datë 28.04.2021, ka sjellë parashtrimet lidhur me çështjen, si dhe ka bashkëlidhur një pjesë të dokumentacionit<sup>8</sup> të kërkuar; të cilat do të shtjellohen në vijim të këtij vendimi.

---

<sup>8</sup> Me shkresën me nr. 1336/1 prot., datë 24.06.2021 ZVAP Shkodër ka dërguar dokumentacion shtesë i cili është depozituar në dosje, në cilësi prove, cituar dhe gjatë shtjellimit e vendimit.

Nëpërmjet shkresës me nr. 558/1 prot., datë 18.05.2021, DRAP Lezhë ka njohur Komisionerin lidhur me qëndrimin e tij përsa i takon pretendimeve të ankueses, si dhe ka bashkëlidhur një pjesë të akteve të kërkuara nga KMD-ja.

Në parashtrimet e saj, DRAP Lezhë informon Komisionerin, ndër të tjera, se: *“Mbi ankimimin e znj. L për përlllogaritjen e pikëve të dosjeve të kandidatëve, sipas shtojcës 5, të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 dhe pas rishqyrtimit të dosjeve nga Komisioni i Vlerësimit të Dosjeve (KVD) në Shkollë të këtij ankimimi, ka marrë parasysh dhe përfunduar procedurën për shpalljen e fituesit sipas procesverbalit nr. 456 prot., datë 25.02.2021, të Sektorit të Shërbimeve pranë ZVAP Shkodër. Në veprimtarinë e saj DRAP Lezhë bazohet në parimet e ligjshmërisë, barazisë dhe paanshmërisë politike”.*

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, me datë 28.06.2021 zhvilloi seancën dëgjimore<sup>9</sup>.

Seanca u zhvillua në datë 28.06.2021, me praninë e palëve në proces: subjektit ankues, si dhe palëve kundër së cilave është paraqitur ankesa: ZVAP Shkodër, përfaqësuar me autorizim<sup>10</sup> nga juristja M. T, dhe DRAP Lezhë<sup>11</sup>, përfaqësuar me autorizim nga juristja N. M.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe që do të shtjellohen, gjatë arsyetimit të vendimit.

Palëve iu bë e njohur e drejta për të paraqitur pranë KMD-së, prova apo parashtrime të tjera shtesë lidhur me pretendimet e tyre.

- Ndërkaq, me shkresën me nr.1668 prot., datë 02.07.2021, ZVAP Shkodër ka dërguar pranë KMD-së, kopje të praktikës së ndjekur nga KVD për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit në IPAP<sup>12</sup> “Agim Tafili”, Bërdicë.
- Subjekti ankues ka depozituar në cilësi prove foto të shkëputura nga rrjetet sociale facebook të drejtuesve të ZVAP Shkodër dhe DRAP Lezhë, nëpërmjet të cilave ka evidentuar pjesëmarrjen e tyre në takime elektorale nën siglën e PS.
- Nga ana e DRAP Lezhë, nuk u depozituan prova apo dokumentacion shtesë lidhur me procedurën se si ishin përlllogaritur pikët e kandidatëve të tjerë të shpallur fitues për pozicionet e drejtorëve pranë IPAP-ve.

---

<sup>9</sup> Njoftuar palëve nëpërmjet shkresës me nr. 616/4 prot., datë 11.06.2021.

<sup>10</sup> Referuar Autorizimit me nr. 1336/2 prot., datë 24.06.2021, të ZVAP Shkodër.

<sup>11</sup> Referuar Autorizimit me nr. 1262 prot., datë 25.06.2021, të DRAP Lezhë.

<sup>12</sup> Akronim për Institucionet Publike të Arsimit Parauniversitar.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.**

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me kandidate të tjerë, në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”.

#### **A.1 Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, për trajtim të padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm nga ana e ZVAP Shkodër, krahasuar me kandidaten E. Rr.**

Në kontekst të legjitimitetit të ankueses kundrejt subjekteve ndaj të cilëve ka pretenduar diskriminimin, *Komisioneri vëren se*, bazuar në kompetencat e sanksionuara nga ligji nr. 69/2012 “*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, *DRAP Lezhë gëzon legjitimitet pasiv në këtë proces, pasi ka tagrin për emërimin e drejtorëve të Institucioneve Publike të Arsimit Parauniversitar (IPAP)*.

Nga ana tjetër, ZVAP Shkodër nuk gëzon legjitimitet pasiv për pretendimin e ankueses për diskriminim lidhur me emërimin e drejtorit të IAP “Pashko Vasa” Shkodër, pasi nuk ka tagrin e emërimit të tij. Bazuar në rolin tejet të veçantë dhe specifik që ka ZVAP, si një hallkë shumë e rëndësishme lidhur me zhvillimin e gjithë procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionin e drejtorit të IPAP, pavarësisht faktit se nuk është vendimmarrëse, Komisioneri do të shqyrtojë edhe veprimet e ZVAP Shkodër dhe ndikimin që ato kanë patur tek vendimmarrja e DRAP Lezhë.

Në mënyrë direkte, e gjithë vendimmarrja e DRAP në përzgjedhjen e drejtorit të IPAP është e bazuar në procedurën e zhvilluar nga ZVAP dhe e kufizuar në përzgjedhjen e dy kandidaturave të klasifikuara me më shumë pikë.

*Në këtë kontekst, Komisioneri, do të marrë në shqyrtim pretendimin e ankueses, lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm të saj nga ana e ZVAP Shkodër.*

Ligji nr. 69/2012 “*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar<sup>13</sup>, në nenin 55 të tij, “*Emërimi dhe shkarkimi i drejtorit të institucionit arsimor*”, ka përcaktuar se:

*“1. Drejtori i institucionit arsimor publik emërohet nga titullari i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar përkatës, pas propozimit të dy kandidatëve që vlerësohen me konkurrim të hapur nga komisioni i vlerësimit. Komisioni përbëhet nga një përfaqësues i njësisë së*

---

<sup>13</sup> Ndryshuar me ligjin nr. 56/2015 dhe me ligjin nr. 48/2018.

vetëqeverisjes vendore, kryetari i bordit të institucionit, kryetari i këshillit të prindërve të institucionit dhe dy mësues të institucionit arsimor të zgjedhur nga këshilli i mësuesve. Njëri prej dy mësuesve, me përvojën më të gjatë në atë institucion arsimor, drejton komisionin e vlerësimit. Procedurat për emërimin dhe/ose shkarkimin e drejtorit të institucionit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

2. Kandidati për drejtor dhe nëndrejtor i institucionit arsimor duhet të ketë, të paktën, kategorinë “Mësues i kualifikuar” dhe të jetë i pajisur me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar. Certifikimi i kandidatit për drejtor dhe nëndrejtor i institucionit arsimor kryhet pas zhvillimit të trajnimit të detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor. Drejtuesi i institucionit arsimor nuk mund të jetë anëtar i forumeve drejtuese të partive politike”.

Sipas përcaktimeve të pikës 1, nenit 55, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, procedurat për emërimin dhe/ose shkarkimin e drejtorit të institucionit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Udhëzimi nr. 2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, ka përcaktuar në mënyrë të detajuar procedurën që duhet ndjekur për emërimin e drejtorit të IPAP, duke specifikuar edhe detyrat e përgjegjësitë e KVD dhe ZVAP.

Pika A) e këtij Udhëzimi, “Shpallja e vendit për drejtor në institucionin publik të arsimit parauniversitar”, ka përcaktuar se:

“1. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP), jo më vonë se dhjetë ditë pune nga krijimi i vendit të lirë për drejtor, njofton zyrtarisht Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) për vendin e lirë të punës.

2. Shpallja e vendit të lirë të punës bëhet nga DRAP jo më vonë se pesë ditë pune nga njoftimi i ZVAP.

3. DRAP shpall vendin e lirë për drejtor të institucionit publik të arsimit parauniversitar (IPAP) në faqen elektronike zyrtare të DRAP dhe të ZVAP, si dhe në këndin e njoftimeve të ZVAP. Shpallja publikohet edhe në këndin e njoftimeve në IPAP, për të cilin bëhet shpallja e vendit të lirë për drejtor.

4. Shpallja e vendit të lirë të punës duhet të përmbajë:

- a) kushtet që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për vendin e lirë për drejtor të IPAP;
- b) dokumentacionin, mënyrën dhe afatin e dorëzimit të tij;
- c) datën e shpalljes së rezultateve të verifikimit paraprak të dokumentacionit;
- d) afatin e plotësimit të dokumentacionit pas verifikimit paraprak të tij;
- e) fushat e njohurive dhe aftësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista e strukturuar
- f) datën e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit të tyre”.

Pika C<sup>14</sup>) e këtij Udhëzimi, ka përcaktuar se:

*“1. Komisioni i shqyrtimit dhe i vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit në IPAP, në vijim Komisioni, ngrihet nga ZVAP;*

*2. Komisioni përbëhet nga:*

*a) kryetari i bordit të IPAP;*

*b) kryetari i këshillit të prindërve të IPAP;*

*c) dy mësues të IPAP të zgjedhur nga këshilli i mësuesve;*

*d) një përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore.*

*3. Këshilli i mësuesve të IPAP zgjedh si anëtarë të Komisionit dy mësues, të përzgjedhur me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë votash;*

*4. Njëri prej dy mësuesve, me përvojën më të gjatë në atë IPAP, drejton Komisionin;*

*5. Anëtarët e Komisionit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikantin, në kuptim të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit. Në mbledhjen e parë të Komisionit, anëtarët plotësojnë deklaratën e konfliktit të interesit, sipas shtojcës nr. 3/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.*

*6. ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP.*

*7. Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote.*

*8. Komisioni mbledhet në mjediset e IPAP ose të ZVAP, jo më vonë se tri ditë pune pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit të aplikimit për drejtor të IPAP dhe kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij.*

*9. Anëtar i Komisionit që mungon, ose që është në konflikt interesi me aplikantin, zëvendësohet. Zëvendësimi kryhet brenda një dite pune nga titullari i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, për anëtarin e zgjedhur prej tij; bordi i IPAP; këshilli i prindërve të IPAP ose këshilli i mësuesve, për anëtarët e zgjedhur prej tyre.*

*10. Komisioni kryen këto detyra:*

*a) bën shqyrtimin paraprak të dokumentacionit të paraqitur në dosjen e aplikimit, brenda dy ditëve pune, sipas shtojcave nr. 1 dhe nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi;*

*b) njofton me shkrim/email aplikantët me mungesa në dokumentacion për mangësitë e konstatuara, duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune;*

*c) pas përfundimit të afatit prej pesë ditë pune, liston aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë, të cilët do të vlerësohen nga Komisioni;*

*d) vlerëson me pikë aplikantët e pranuar, kandidatë për drejtor të IPAP, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi.*

*e) realizon intervistën e strukturuar me secilin kandidat për fushat e njohurive dhe aftësitë për drejtimin e institucionit. Çdo anëtar i Komisionit e vlerëson intervistën me pikë nga 1 në 10;*

*f) harton tabelat e pikëve dhe rendit kandidatët sipas shumës së përgjithshme të pikëve, në rendin zbritës;*

---

<sup>14</sup> “Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit në IPAP”.

g) brenda tri ditëve pune, shpall në këndin e njoftimeve të IPAP tabelat e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës nr. 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

11. Kandidatët kanë në drejtë të paraqesin ankim me shkrim para Komisionit brenda 3 ditëve pune nga shpallja e rezultateve të konkurrimit. Komisioni shqyrton ankesat brenda një dite pune.

12. Kryetari i Komisionit i dorëzon drejtorit të ZVAP dosjet e aplikimit dhe vlerësimin me pikë për dy kandidatët me më shumë pikë. Kopjet e këtyre dokumenteve dhe dosjet e aplikantëve të tjerë ruhen në arkivin e shkollës”.

Pika D<sup>15</sup>) e Udhëzimit, ka përcaktuar se:

“1. Sektori i Shërbimeve në ZVAP, ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknike.

2. Drejtori i ZVAP, brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, përcjell dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë në DRAP.

3. Drejtori i DRAP, brenda pesë ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit nga ZVAP, interviston dy kandidatët.

4. Intervistat regjistrohen nga sekretari i drejtorit të DRAP dhe arkivohen në DRAP.

5. Brenda tri ditëve pune nga realizimi i intervistës me kandidatët, drejtori i DRAP shpall vendimin për kandidatin fitues për pozicionin e drejtorit të IPAP.

6. Kandidati jofitues, ka të drejtë të paraqesë ankesë në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR), brenda tri ditëve pune nga shpallja e kandidatit fitues.

7. MASR shqyrton ankesën dhe jep përgjigjen brenda dhjetë ditëve pune, pas përfundimit të afatit për ankim.

8. Drejtori i DRAP bën emërimin e drejtorit të IPAP. Vendimi i emërimit i komunikohet zyrtarisht ZVAP. ZVAP i dërgon vendimin e emërimit drejtorit të sapoemëruar dhe drejtorit zëvendësues.

9. Drejtori i IPAP nuk duhet të bëjë pjesë, pas emërimit, në forumet drejtuese të partive politike”.

Në analizë të sa më sipër, si dhe bazuar në kronologjinë e ngjarjeve, provat dhe dokumentacionin e sjellë nga palët në këtë proces, Komisioneri vëren se:

- Me shkresën me nr. 1418 prot., datë 04.08.2020 dhe me Urdhrin nr. 23, datë 04.08.2020, DRAP Lezhë ka ngarkuar ZVAP Shkodër për shpalljen e procedurave të konkurimit për drejtues të IPAP në juridiksionin e ZVAP Shkodër.
- Nëpërmjet e-mailit të datës 24.08.2020 DRAP Lezhë ka njoftuar ZVAP Shkodër për pezullimin e procedurës për konkurim për pozicionin drejtor në shkollën 9-vjeçare “Pashko Vasa” Shkodër, deri në përfundim të inspektimit që DRAP Lezhë do të zhvillojë në ditët në vijim, nisur nga ankesa e paraqitur nga D. G.
- Me e-mailin e datës 24.08.2020 ZVAP Shkodër ka kërkuar të sqarohet nga DRAP Lezhë, se si duhet të veprojë pas përfundimit të inspektimit të tyre.
- Në vijim të kërkesës së ZVAP Shkodër, DRAP Lezhë i ka informuar se do të rishpallë procedurën e konkurimit për këtë shkollë në fazën e tretë të shpalljeve.

---

<sup>15</sup> “Procedura e emërimit të drejtorit të IPAP nga drejtori i DRAP”.

- Me Urdhrin nr. 86, datë 28.09.2020, ZVAP Shkodër ngriti Komisionin e shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit të IPAP “Pashko Vasa” Shkodër (në vijim, Komisioni ose KVD)
- DRAP Lezhë, me Urdhrin nr. 52, datë 10.09.2020 *“Për shpalljen e procedurave të konkurimit për drejtues të IAP në juridiksionin e ZVAP Shkodër”*, ka ngarkuar ZVAP Shkodër për shpalljen e procedurës së konkurimit për drejtues të IPAP “Pashko Vasa”.
- Me e-mailin e datës 03.11.2020, Kryetarja e Komisionit, ka informuar nëpërmjet një relacioni dhe dokumentave DRAP Lezhë, ZVAP Shkodër dhe kandidatët për drejtues të IPAP “Pashko Vasa” mbi kronologjinë e ecursisë së KVD, duke parashtruar faktet se afatet ligjore të përcaktuara në Urdhrin e DRAP Lezhë nuk ishin zbatuar për shkak të mosparaqitjes së anëtarëve të KVD-së prej situatës së covid-19.
- Me Urdhrin nr. 11, datë 03.12.2020 *“Për shpalljen e procedurave të konkurimit për drejtues të IAP në juridiksionin e ZVAP Shkodër”*, DRAP Lezhë ka ngarkuar ZVAP Shkodër, të shpallë procedurën e konkurimit për drejtues të IPAP edhe për shkollën 9-vjeçare “Pashko Vasa”.
- Nëpërmjet Urdhrit nr. 118, datë 17.12.2020 ZVAP Shkodër ka urdhëruar ngritjen e KVD për pozicionin e drejtorit të IPAP “Pashko Vasa”.
- Bazuar në Urdhrat nr. 120, datë 24.12.2020, me nr. 121, datë 28.12.2020 dhe me nr. 11, datë 19.01.2021 të ZVAP Shkodër, përbërja e KVD është ndryshuar 3 herë.
- Me datë 28.01.2021 KVD ka njoftuar palët e përfshira (kandidatët, ZVAP Shkodër, DRAP Lezhë) për përfundimin e shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit të IPAP “Pashko Vasa” Shkodër.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 269 prot., datë 02.02.2021 subjekti ankues duke mos qenë dakord me mënyrën e përlllogaritjeve të pikëve të bëra nga KVD, ka ushtruar të drejtën e ankimit.
- Mbështetur në e-mailin e protokolluar me shkresën nr. 269/1 prot., datë 08.02.2021 KVD i është përgjigjur ankueses, njëherësh duke vënë në dijeni edhe ZVAP Shkodër dhe DRAP Lezhë, ndër të tjera se: *“Ankimi juaj nuk mund të merret parasysh nga ana e KVD në lidhje me përlllogaritjen e pikëve që ju pretendoni. Vlerësimi i kandidatëve nuk mund të ndryshojë, mbetet i njëjti”*.
- Bazuar në e-mailin e protokolluar me shkresën me nr. 339 prot., datë 08.02.2021, KVD ka dërguar pranë ZVAP Shkodër dosjet e dy aplikantëve për pozicionin e drejtorit të IPAP “Pashko Vasa”, të vlerësuar me më shumë pikë, pas fazës së parë të shqyrtimit të tyre.
- Pas ankimit të ankueses pranë DRAP Lezhë për mënyrën e përlllogaritjes së pikëve të dosjeve të kandidatëve nga KVD, DRAP Lezhë i është drejtuar ZVAP Shkodër<sup>16</sup> nëpërmjet e-mailit të datës 09.02.2021, duke kërkuar që të merreshin masa për përlllogaritjen e pikëve sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 5, të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 të MASR.
- Referuar e-mailit të protokolluar me shkresën me nr. 339/1 prot., datë 10.02.2021, rezulton që ZVAP Shkodër ka urdhëruar KVD të paraqitej pranë ambjenteve të saj, për tërheqjen e dosjeve të dorëzuara me datë 08.02.2021.

---

<sup>16</sup> Komunikimi me e-mail ndërmjet këtyre dy institucioneve është protokolluar nga ZVAP Shkodër nëpërmjet shkresës me nr. 339/1 prot., datë 10.02.2021.

- Me shkresën me nr. 429 prot., datë 22.02.2021, KVD ka përcjellë pranë ZVAP Shkodër procesverbalin e mbajtur nga anëtarët e tij, të cilët kanë dalë në përfundimin se vlerësimi prej tyre është bërë i saktë dhe kanë dalë në po të njëjtat konkluzione, duke përcaktuar si kandidatët me më shumë pikë: E. Rr dhe L. M.
- Përgjigjja e KVD dhe ZVAP Shkodër i është përcjellë DRAP Lezhë me shkresën me nr. 456/1 prot., datë 25.02.2021.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri, vlerëson se, ZVAP Shkodër nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore lidhur me zhvillimin e procedurës për emërimin e drejtorit të IPAP “Pashko Vasa” Shkodër, dhe është në shkelje të tyre:

*Së pari*, Udhëzimi nr. 2, datë 28.01.2020 “*Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar*”, ka të përcaktuara afate kohore për çdo hallkë të procesit për emërimin e drejtorit të IPAP.

Nga krijimi i vendit të lirë për drejtor dhe deri në vendimin e emërimit, afati maksimal sipas udhëzimit të mësipërm është 49 ditë, ku janë të përfshira edhe afatet e ankimimeve në KVD, ZVAP, DRAP dhe MASR.

Në rastin konkret, ky afat është shkelur, duke shkuar në mbi 7 muaj (*gusht 2020 - mars 2021*), shoqëruar më shtyrje, anulime, pezullime dhe shpallje 3 herë, me rifillim të procesit nga e para- të paargumentuara dhe të pamotivuara ligjërisht.

Udhëzimi i mësipërm, nuk njeh dhe nuk ka parashikuar konceptin e pezullimit, shtyrjes apo shpalljes tre herë të vendit vakant. Procesi është parashikuar si një i tërë dhe koherent, përmbyllja e të cilit duhet realizuar brenda 49 ditëve. Tejkalmi i afateve, sipas Udhëzimit, shoqërohet me masë disiplinore për drejtorin e ZVAP<sup>17</sup>, gjë e cila nuk rezulton të ketë ndodhur në rastin konkret, pasi, pjesë e zvarritjes së procesit është bërë edhe vetë DRAP Lezhë, me veprime apo mosveprime, jo në përputhje me ushtrimin e rregullt të detyrës.

Ankuesja ka pretenduar se kjo tejzgjatje e procesit është bërë me qëllim të përgatitjes së dokumentacionit nga E. Rr dhe përfshirjes së saj në konkurim.

Është fakt i dukshëm se E. Rr është përfshirë në konkurimin<sup>18</sup> për vendin e lirë të drejtorit, vetëm në shpalljen e tretë (dhjetor 2020), dhe se tejzgjatja e procesit është e papërligjur.

Nga ana e ZVAP Shkodër nuk u sollën argumenta apo prova që të justifikonin veprimet e tyre. Kështu, lidhur me argumentin se në një rast procedura është shtyrë (shpallur sërish në një datë të mëvonshme) për shkak se disa nga anëtarët e KVD ishin të infektuar me covid-19, nuk provohet me dokumentacion mjekësor.

<sup>17</sup> Shkronja E, pika 3, e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 “*Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar*”: “*Tejkalmi i afateve të përcaktuara në kreun I të këtij udhëzimi shoqërohet me masë disiplinore për drejtorin e ZVAP*”.

<sup>18</sup> Bazuar në kërkesën datë 11.12.2020, të E. Rr drejtuar ZVAP Shkodër dhe DRAP Lezhë, për të konkuruar për vendin e lirë të drejtorit të IPAP “Pashko Vasa”, Shkodër.

Por edhe në këtë rast, Udhëzimi i posaçëm<sup>19</sup>, ka përcaktuar dhe detajuar në mënyrë të qartë për secilin nga anëtarët se: *“Anëtari i Komisionit që mungon, zëvendësohet dhe se zëvendësimi i tij, kryhet brenda një dite pune”*, ndaj, Komisioneri vlerëson se, ZVAP Shkodër është në shkelje të këtij akti nënligjor.

Së dyti, lidhur me përlogaritjen e pikëve të dosjeve të kandidatëve për drejtor, nga ana e KVD dhe vlerësimit të ZVAP Shkodër, Komisioneri vëren se:

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve për drejtor të IPAP është përcaktuar në mënyrë të detajuar në Shtojcën 5, të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 *“Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”*.

“Tabela e vlerësimit për kandidatët për drejtor të IPAP”, ka detajuar vlerësimin sipas pikëzimit, si më poshtë:

1. Nota mesatare e studimeve të larta (0-5 pikë)
2. Shkallët e kualifikimit (0-3 pikë)
3. Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja (0-4 pikë)
4. Certifikata trajnimesh (0-2 pikë)
5. Vjetërsi pune në arsim (1-5 pikë)
6. Vjetërsi pune në pozicion drejtues (0-4 pikë)
7. Arsim shtesë në fushën e arsimit (0-2 pikë)
8. Studime doktorature në fushën e arsimit (0-2 pikë)
9. Provimet kombëtare - Administrator/Hartues testi/Korrigjues teste kombëtare (0-1 pikë)
10. Autor në tekstet shkollore/për mësuesit/për drejtimin e shkollës (0-1 pikë)
11. Shkrime për drejtimin e shkollës/Kumtesa në takime ndërkombëtare për arsimin (0-1 pikë)
12. Intervista e strukturuar (0-10 pikë)

Shuma e pikëve në total = 40 pikë.

Bazuar në sa më sipër, si dhe nga analizimi i dokumentacionit të disponuar, rezulton se, KVD ka keqzbatuar duke shkelur haptazi Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020 *“Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”*, përse i përket metodologjisë së caktimit të pikëve të dosjeve të aplikantëve për drejtor të IPAP “Pashko Vasa” Shkodër, e për rrjedhojë edhe të përlogaritjes përfundimtare të tyre.

Referuar Shtojcës 5, të Udhëzimit sipërcituar, evidentohet se pikët maksimale që mund të fitohen nga kandidati, nga shqyrtimi i dosjes janë 30 pikë, dhe pikët maksimale që mund të fitohen nga intervista e strukturuar janë 10. Në përfundim të përlogaritjeve, rezulton që maksimumi i pikëve që mund të fitohen nga një kandidat është 40 pikë në total.

- KVD ka vlerësuar mbi bazë dokumentacioni secilin nga kandidatët, respektivisht si më poshtë:

---

<sup>19</sup> Udhëzimi nr. 2, datë 28.01.2020 *“Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”*.

A. L (subjekti ankues), vlerësuar me 85.5 pikë.  
E. Rr., vlerësuar me 101.5 pikë.  
L. M, vlerësuar me 91 pikë.  
M. Q, vlerësuar me 63 pikë.

Nga të dhënat më sipër, rezulton që KVD, ka përlogaritur pikët për secilin kandidat, duke shumëzuar rezultatin me 5 (që është numri i anëtarëve të KVD), në kundërshtim me sa ka përcaktuar Shojca 5, e Udhëzimit përkatës.

Komisioneri konstaton se, lidhur me sa më sipër, përlogaritja për secilin kandidat duhet të ishte bërë si më poshtë:

A. L (subjekti ankues), duhet të ishte vlerësuar me 17.1 pikë.  
E. Rr., me 20.3 pikë.  
L. M, me 18.2 pikë.  
M. Q, me 12.6 pikë.

- KVD ka vlerësuar pas intervistës, është si më poshtë:

A. L (subjekti ankues), vlerësuar me 9.8 pikë.  
E. Rr., vlerësuar me 4.6 pikë.  
L. M, vlerësuar me 9.6 pikë.  
M. Q, vlerësuar me 8.6 pikë.

Në këtë rast, përlogaritja e pikëve të intervistës së kandidatëve, nga KVD është bërë konform përcaktimeve të Shtojcës 5, ndryshe nga sa ka aplikuar në përlogaritjen e pikëve të dokumentacionit të dosjeve të tyre.

- Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve, sipas përlogaritjes së pikëzimit të bërë nga Komisioni, është:

E. Rr., vlerësuar me 105.6 pikë.  
L. M, vlerësuar me 100.6 pikë.  
A. L (subjekti ankues), vlerësuar me 95.3 pikë.  
M. Q, vlerësuar me 71.6 pikë.

Komisioneri vlerëson se, metodologjia në përlogaritjen e pikëve, që Komisioni u ka bërë dosjeve të kandidatëve, është e gabuar dhe në kundërshtim me aktin nënligjor (Udhëzimin), gjë e cila ka pasqyruar pikëzimin më të ulët të ankueses, pasi pesëfishimi që i është bërë pikëve të dosjeve të aplikantëve ka thelluar diferencën (psh. një kandidat duke patur një pikë më shumë në dokumentacion, kur pesëfishohet ka 5 pikë më shumë, ndërkohë që për intervistën është ndjekur standard tjetër (ai që përcaktohet në Udhëzimin përkatës), duke bërë që në përfundim të përlogaritjes rezultati të dalë i deformuar dhe jo i saktë.

Në këtë kontekst, nëse përlogaritja do të ishte sipas përcaktimeve të Shtojcës 5, rezultati përfundimtar do të ishte krejt i ndryshëm. Kështu, respektivisht:

A. L (subjekti ankues), duhet të ishte vlerësuar në total me 26.9 pikë.  
E. Rr., me 24.9 pikë.  
L. M, me 27.8 pikë.  
M. Q, me 21.2 pikë.

Pra, sikurse shihet qartë, kandidatët me më shumë pikë do të ishin, L.M dhe ankuesja, ndërsa kandidatja që rezultoi fituese, E. Rr. nuk do të ishte fare në kandidaturat që i duheshin dërguar DRAP Lezhë për të vijuar me procedurën e përzgjedhjes së kandidatit fitues për drejtor të IPAP “Pashko Vasa”.

Udhëzimi sipërcituar, ka përcaktuar ndër të tjera, se: *“Sektori i Shërbimeve në ZVAP, ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknike”*.

Pra, Udhëzimi ka përcaktuar se dokumentacioni i kthehet Komisionit në rastet kur konstatohen parregullsi të natyrës teknike. ZVAP Shkodër nuk ka vepruar për ta korrigjuar metodologjinë e përlllogaritjes së pikëve të dosjeve, sipas këtij detyrimi normativ.

Edhe pas urdhërimit nga DRAP Lezhë, (pas ankimimit të subjektit ankues), ZVAP Shkodër dhe KVD e ngritur prej saj, nuk kanë reflektuar për pikëzimin e dosjeve të kandidatëve sipas Shtojcës 5, të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 *“Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”*, por kanë ngulmuar në caktimin e pikëzimit sipas metodologjisë së tyre, dukshëm dhe haptazi të gabuar; duke vepruar në kundërshtim me Udhëzimin, si dhe duke shpërfillur urdhërimin e organit epror, DRAP Lezhë.

*Komisioneri konstaton, se:*

- Qëndrimi i mbajtur nga ana e ZVAP Shkodër dhe mosveprimi i saj, në lidhje me metodologjinë e gabuar të caktimit dhe përlllogaritjes së pikëve të dosjeve të kandidatëve bie ndesh me Udhëzimin<sup>20</sup>.
- ZVAP Shkodër kishte detyrimin ligjor që të konstatonte kryesisht, shkeljen flagrante të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 *“Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”*, në caktimin e pikëve të dosjeve të kandidatëve, shkelje e cila është reflektuar në eliminimin e ankuese nga kandidaturat për drejtor të IPAP “Pashko Vasa” Shkodër.
- Pretendimi i ZVAP Shkodër se *“shqyrton dokumentacionin e Komisionit (KVD) dhe e kthen atë vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknike, dhe se në këtë rast nuk kishin të bënë me parregullsi teknike”*, është absurd dhe i pabazuar.
- Ndryshimi i metodologjisë së caktimit të pikëve, është mirëfilli një parregullsi teknike e bërë me vetëdije nga KVD, dhe e lejuar e miratuar po me vetëdije nga ZVAP Shkodër (dhe DRAP Lezhë, gjithashtu).

---

<sup>20</sup>Udhëzim nr. 2, datë 28.01.2020 *“Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”*.

- Është pikërisht kjo parregullsi teknike që ka cënuar në thelb parimin e konkurimit, barazisë e meritokracisë, dhe në analizë të fundit, ka kualifikuar një kandidate që nuk duhej kualifikuar, dhe që u emërua drejtore e IPAP “Pashko Vasa” Shkodër, dhe ka skualifikuar fare ankuesen (e cila duhej kualifikuar) ndër kandidaturat për emërim.
- ZVAP Shkodër nuk ka përmbushur kërkesat e DRAP Lezhë<sup>21</sup>, që të merreshin masa për përlllogaritjen e pikëve sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 5, të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 të MASR.
- KVD është një komision ad-hoc anëtarët e të cilit emërohen sipas procedurës së Udhëzimit, dhe se KVD, në rastet e vlerësimit të dosjeve të kandidatëve duhet të udhëhiqet nga parimi i pavarësisë e paanësisë, dhe kur këto parime cënohen, si ZVAP Shkodër, ashtu dhe DRAP Lezhë, në zbatim të parimit të kontrollit dhe ligjshmërisë duhej të kishin reaguar duke mos legjitimuar këtë shkelje ligjore.
- Komisioneri vlerëson se, ankuesja është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme krahasuar me kandidaten e fituese, bazuar pikërisht në mënyrën e pikëzimit të dosjeve të tyre, pasi duke e shumëzuar rezultatin me 5 (pesë), E. Rr. favorizohet duke u klasifikuar si kandidatja me më shumë pikë (105.6 pikë) kur do të duhej të ishte renditur e treta me 24.9 pikë.
- KVD ka ndjekur standarde të ndryshëm në metodologjinë për pikëzimin e dosjeve, nga ai për metodologjinë për vlerësimin me pikë të intervistave të kandidatëve.
- Argumenti i sjellë nga ZVAP Shkodër se një praktikë e tillë vlerësimi është ndjekur edhe për një rast tjetër, në përzgjedhjen e drejtorit të IPAP “Agim Tafili” Bërdicë, nuk qëndron e nuk legjitimon situatën e krijuar për rastin konkret, për shkak se:

*Së pari*, rasti i sjellë për ilustrim nuk është i njëjtë me rastin e ankueses, pasi:

- Faktet e sjella nuk janë të plota dhe nuk evidentohet se si është renditja e përlllogaritja e pikëve për të gjithë aplikantët, por vetëm për dy kandidatët me më shumë pikë.

*Së dyti*, bazuar në dokumentacionin e sjellë, mënyra e përlllogaritjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve fitues për përzgjedhjen e drejtorit të IPAP “Agim Tafili” Bërdicë, nga ana e KVD, nuk ka afektuar, e për rrjedhojë as deformuar rezultatin përfundimtar, për këto arsye:

- KVD ka aplikuar të njëjtën mënyrë vlerësimi, duke shumëzuar rezultatin e secilit anëtar me 5, edhe në vlerësimin e dokumentacionit, edhe në vlerësimin e intervistës.
- Nga ana tjetër, në çdo rast, renditja e dy kandidateve mbetet e njëjtë.
- V. H është vlerësuar me 89.5 pikë ose 17.9 x 5 për dokumentacionin e dosjes.
- I. P është vlerësuar me 67 pikë ose 13.4 x 5 për dokumentacionin e dosjes.
- Ndërsa, tek intervista V. H është vlerësuar me 50 pikë ose 10 x 5, ndërsa I. P nuk ishte paraqitur fare për intervistë.
- Gjithashtu nuk rezulton, nëse ka patur ankimim nga kandidatë të tjerë për këtë rast.

---

<sup>21</sup> Referuar e-malit të datës 09.02.2021, të DRAP Lezhë, protokolluar pranë ZVAP Shkodër, me shkresën me nr. 339/1 prot., datë 10.02.2021.

Komisioneri vlerëson se, referuar standardit të mbajtur nga ZVAP Shkodër, në përzgjedhjen e kandidatëve për drejtor të IPAP “Agim Tafili” Bërdicë, në raport me rastin e ankueses, kemi haptazi trajtim të pafavorshëm të ankueses.

**Në përfundim, bazuar në shqyrtimin e fakteve, provave dhe bazës ligjore sipërcituar, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues, është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm krahasuar me standardin e ndjekur për rastin e V. H, nga ana e ZVAP Shkodër, përsa i takon procedurës për përzgjedhjen e dy kandidatëve me më shumë pikë.**

## **A.2 Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, për trajtim të padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm nga ana e DRAP Lezhë, krahasuar me kandidaten E. Rr.**

Në pikën 11 të VKM nr. 99, datë 27.02.2019 *“Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”,* përcaktohet që: *“Drejtorët e Drejtorive Rajonale emërojnë drejtorët e institucioneve arsimore publike (IAP), sipas udhëzimit përkatës të Ministrisë”.*

Udhëzimi nr. 2, datë 28.01.2020 *“Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”,* ka përcaktuar në mënyrë të detajuar procedurën që duhet ndjekur për emërimin e drejtorit të IPAP. Në shkronjën D), pika 8 e tij, Udhëzimi ka përcaktuar se, kompetencën për emërimin e drejtorit të IPAP e ka drejtori i DRAP.

*Bazuar në provat, deklaratimet, dokumentacionin e sjellë nga palët, si dhe referuar kronologjisë së ngjarjeve e veprimeve, rezulton se:*

- Referuar Urdhrave të DRAP Lezhë, të cituar shprehimisht në faqen 9-10 të Vendimit, rezulton se, procedura e shpalljes së vendit vakant për drejtor në IPAP “Pashko Vasa” Shkodër është përsëritur tre herë, deri në datën 03.12.2020 kur është bërë shpallja e fundit, bazuar në të cilën ka iniciuar procedura për përzgjedhjen e kandidatit fitues për këtë pozicion.
- Në zbatim të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 *“Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”,* me Urdhrin nr. 111, datë 03.12.2020, DRAP Lezhë ka shpallur konkurimin për vendin vakant “Drejtor” në shkollën 9- vjeçare “Pashko Vasa” Shkodër.
- Me Urdhrin nr. 118, datë 17.12.2020 të ZVAP Shkodër është ngritur KVD pranë IPAP “Pashko Vasa” Shkodër, i cili referuar Urdhrave me: nr. 120, datë 24.12.2020, nr. 121, datë 18.12.2020, nr. 11, datë 19.01.2021 dhe nr. 18, datë 26.01.2021, ka ndryshuar disa herë përbërjen e anëtarëve të tij.
- Bazuar në procesverbalin e datës 28.01.2021, rezulton se, KVD ka proceduar me vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për pozicionin e drejtorit të IPAP “Pashko Vasa” Shkodër.
- Me datë 01.02.2021 KVD ka realizuar intervistat e strukturuar me kandidatët për pozicionin e drejtorit pranë kësaj IPAP, dhe me datë 02.02.2021 ka shpallur renditjen e

kandidatëve sipas vlerësimit përfundimtar të tyre (mbi bazën e dokumentacionit dhe intervistës së strukturuar).

- Pasi është njohur me rezultatet e shpallura, subjekti ankues, nëpërmjet shkresës me nr 269 prot., datë 02.02.2021 ka kundërshtuar vlerësimin e bërë pranë KVD.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 269/1 prot., datë 08.02.2021 KVD në kthim përgjigjen drejtuar ankueses i ka bërë me dije se vlerësimi është i saktë nga ana e tyre dhe se është bërë bazuar në përcaktimet e Udhëzimit respektiv.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 346 prot., datë 09.02.2021, ankuesja ka kundërshtuar pranë ZVAP Shkodër dhe DRAP Lezhë, vlerësimin e bërë nga KVD, si të gabuar dhe jashtë kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin përkatës.
- Me datë 09.02.2021, DRAP Lezhë, në vijim të shqyrtimit të pretendimit të ankueses, i është drejtuar ZVAP Shkodër, duke e njoftuar se gjen të bazuar kërkesën e saj lidhur me përllogaritjen e pikëve të dosjeve të kandidatëve, dhe ka kërkuar nga kjo e fundit dhe KVD të merren masa për pikëzimin e dosjeve sipas shtojcës 5, të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 të MASR.
- Megjithë urdhërimin e DRAP Lezhë për përsëritjen e procedurës së pikëzimit të kandidatëve, në përputhje strikte me Udhëzimin, KVD dhe ZVAP Shkodër duke shpërfillur hapur institucionin epror e në shkelje të normave të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 *“Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”*, kanë bërë pikëzimin e renditjen e kandidatëve, identike sikurse herën e parë, duke dërguar pranë DRAP Lezhë, me shkresën nr. 436/1 prot., datë 25.02.2021, të njëjtët kandidat (E. Rr dhe L. M) me të njëjtat pikë dhe renditje.
- Me datë 05.03.2021 DRAP Lezhë ka zhvilluar intervistat me dy kandidatet dhe me datë 11.03.2021 ka shpallur vendimin për kandidaten fituese, konkretisht E. Rr.
- Me Urdhrin nr. 70, datë 17.03.2021, *“Për emërim definitiv në detyrë”*, DRAP Lezhë ka emëruar E. Rr në detyrën e drejtorit të shkollës 9-vjeçare *“Pashko Vasa”* Shkodër.

*Bazuar në veprimet dhe procedurën e ndjekur nga DRAP Lezhë, Komisioneri vlerëson se:*

- Pas ankimimit të ankueses, *(por dhe kryesisht, në rastet kur konstaton parregullsi në procedurën e ndjekur)*, DRAP Lezhë kishte detyrimin që bazuar në kompetencat e tij funksionale, jo thjesht të kërkonte *formalisht* nga ZVAP Shkodër të ndërmerre masa për vlerësimin e dosjeve konform përcaktimeve të Udhëzimit respektiv, por të mbante qëndrim konsequent në kontrollin dhe zbatimin e parimit të ligjshmërisë, duke ushtruar përgjegjshmëri dhe autoritet institucional.
- DRAP Lezhë, me të drejtë ka konstatuar se, mënyra e përllogaritjes së pikëve të dosjeve të kandidatëve, duke e shumëzuar rezultatin me 5 (pesë) ishte e gabuar, dhe se vlerësimi i dosjeve të secilit kandidat nuk duhet të kalonte 30 pikë, dhe se po ashtu, vlerësimi përfundimtar i kandidatëve nuk duhet të kalonte 40 pikët maksimale, sipas Shtojcës 5, të Udhëzimit.
- Pavarësisht këtij konstatimi, dhe standardit të ndryshëm të përllogaritjes së pikëve të dosjeve me atë të pikëve të intervistës së strukturuar *(dhe pasi ZVAP Shkodër është urdhëruar nga DRAP Lezhë, ky i fundit ka përsëritur të njëjtën procedurë pa ndrequr asnjë*

*pasojë të krijuar, duke ridërguar të njëjtat dosje kandidatësh, me të njëjtin sistem pikëzimi dhe mënyrë vlerësimi).*

- DRAP Lezhë ka vijuar me fazën tjetër të procedurës së vlerësimit të kandidaturave, duke legjitimuar kështu parregullsitë të cilat vetë i kishte evidentuar dhe kërkuar që të ndreqeshin.
- DRAP Lezhë me veprime konkludente të vetëdijshme dhe në mungesë të përgjegjshmërisë institucionale e ligjore ka emëruar kandidaten E. Rr në pozicionin e drejtorit të Shkollës, pavarësisht faktit të pranuar dhe të deklaruar prej saj, se përlllogaritja e pikëve të dosjes ishte bërë në mënyrë të gabuar dhe të pa mbështetur në përcaktimet ligjore të Udhëzimit përkatës të MASR.
- Komisioneri konstaton se, nëse vlerësimi do të ishte kryer sipas përcaktimeve të aktit nënligjor specifik, E. Rr, nuk do të ishte kualifikuar në kandidatet me më shumë pikë, pasi do të renditej e treta, ndërsa ankuesja ndër dy kandidaturat.
- Për sa më sipër, me mënyrën gabuar të përlllogaritjes së pikëve të dosjeve, ankuesja është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme krahasuar me E. Rr, duke sjellë për rrjedhojë skualifikimin e ankuses nga e drejta e përzgjedhjes për pozicionin e drejtorit të Shkollës.
- DRAP Lezhë ka pranuar<sup>22</sup> se në raste të tjera, lidhur me emërimin e drejtorëve të IPAP, përsa i takon procedurës së ndjekur për pikëzimin e dosjeve të aplikantëve, mënyra e përlllogaritjes së pikëve ka qenë konform shtojcës 5, të Udhëzimit. Pra jo më shumë se 30 pikë për secilin kandidat, dhe jo më shumë se 40 pikë në total në vlerësimin përfundimtar për secilin prej tyre.
- Për rrjedhojë, të gjitha këto fakte provojnë trajtimin e pafavorshëm që i është bërë ankuses, duke e skualifikuar nga gara e mëtejshme, nga njëra anë, dhe trajtimin preferencial që i është bërë kandidatës E. Rr me qëllim favorizimin e saj në mënyrë që të renditej në dy kandidaturat me më shumë pikë, duke passjellë edhe përzgjedhjen e saj si drejtoreshë e shkollës 9-vjeçare “Pashko Vasa” Shkodër.

Pra, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, referuar standardit të mbajtur nga DRAP Lezhë, për këtë rast, kemi haptazi trajtim të pafavorshëm të ankuses, në raport me kandidaten E. Rr, me qëllim favorizimin e kësaj të fundit për kualifikimin e saj me më shumë pikë.

**Në përfundim, bazuar në analizimin e fakteve, provave dhe bazës ligjore sipërcituar, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues, është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm krahasuar me përcaktimet ligjore dhe standardin e krijuar për emërimin e drejtorëve të IPAP, nga ana e DRAP Lezhë, përsa i takon procedurës së ndjekur për emërimin e drejtorit të shkollës 9-vjeçare “Pashko Vasa” Shkodër.**

---

Bazuar në deklaratimet e përfaqësueses së DRAP Lezhë gjatë seancës dëgjimore, datë 28.06.2021, pranë Zyrës së KMD.

## B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2<sup>23</sup>, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ky ligj, ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Mbështetur në nenin 9/2 të Kodit të Punës, mbrojtja nga diskriminimi garantohet bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar se: “Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët”.

Në të drejtën ndërkombëtare, shpesh përdoret termi *mendimi politik dhe tjetër* (ang. *Political and other opinion*), dhe me këtë përfshihet dhe përkatësia politike. Përkatësia politike duhet të interpretohet në mënyrë që të mbulojë lidhshmërinë me ndonjë opion të caktuar politik ose parti politike, me të cilën do t’i përfshijë dhe rastet kur bëhet fjalë për përkatësinë formale (anëtarësinë), por dhe llojet e tjera të lidhjeve, përmes të cilave mund të tregohet lidhshmëri me ndonjë parti ose opion tjetër politik. Mendimi politik dhe tjetër përfshin të gjitha këto, por dhe pasjen dhe mospasjen e mendimit për ndonjë opion ose parti të caktuar politike (përfshirë këtu dhe politikën konkrete, sistemin ose mënyrën e sundimit) dhe shprehjen e saj (individuale ose me formë të organizuar). Me qëllim interpretimi sa më gjithëpërfshirës të këtij shkaku, i cili duhet të jetë në pajtueshmëri me të drejtën dhe praktikën ndërkombëtare, rekomandohet që në këtë shkak të përkatësisë politike, të përfshihen rastet e anëtarësisë formale ose joformale dhe llojet e tjera të

---

<sup>23</sup> “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

lidhjes me partitë politike, siç janë pasja ose mospasja e mendimit për ndonjë opsion ose parti të caktuar politike<sup>24</sup>.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson si shkak të njohur nga LMD si “bindje politike” edhe mospasjen e bindjeve të caktuara politike.

## **B/1 Bindjet politike**

Ankuesja ka pretenduar diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”, duke shpjeguar se në ndryshim nga E. Rr, kandidatja e shpallur fituese për pozicionin e drejtorit të IPAP “Pashko Vasa” Shkodër, e cila është përkrahëse e forcës politike në pushtet, ankuesja nuk ka asnjë bindje politike dhe nuk përkrah asnjë forcë politike, gjë e cila e ka penalizuar në procedurën e ndjekur për emërimin e drejtorit të shkollës 9-vjeçare “Pashko Vasa” Shkodër.

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ky shkak i pretenduar nga ankuesi konsiderohet si shkak i mbrojtur, si dhe subjekti ankues ka shpjeguar bindshëm se e mbart atë.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme dhe të padrejta që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Ankuesja ka pretenduar se i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm për shkak të “*bindjeve politike*” pasi ajo nuk ka asnjë bindje politike, në ndryshim nga bindjet politike të ekspozuara të kandidatës fituese E. Rr, si dhe të drejtuesve të institucioneve përgjegjëse ZVAP Shkodër dhe DRAP Lezhë, që kanë ndjekur, zbatuar e kontrolluar, procedurën për përzgjedhjen dhe emërimin e drejtorit të shkollës 9-vjeçare “Pashko Vasa” Shkodër:

Bindja politike, shpesh është arsye për trajtim diskriminues dhe përfshin qoftë mbajtjen apo mos mbajtjen e saj, si edhe shprehjen e pikëpamjeve ose anëtarësinë në organizata politike, parti politike.

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, shkakut i bindjeve politike, i pretenduar nga ankuesja, konsiderohet si shkak i mbrojtur dhe diferencat në trajtim bazuar në këtë shkak janë të ndaluara dhe të mbrojtura nga ligji.

---

<sup>24</sup> <https://www.osce.org/files/f/documents/4/2/117992.pdf>

Ankuesja, përveç prezantimit të procedurës së ndjekur dhe fakteve që kanë shoqëruar përzgjedhjen e drejtorit të Shkollë, ka depozituar edhe foto të ndryshme nëpërmjet të cilave ka faktuar pjesëmarrjen e drejtores aktuale, E. Rr, të Shkollës, drejtueses së ZVAP Shkodër, B. N; drejtuesit të DRAP Lezhë, B. P, në aktivitetet politike të organizuara nga PS<sup>25</sup>, kryesisht gjatë fushatës elektorale të zgjedhjeve të përgjithshme kombëtare, të 25 prillit 2021.

Komisioneri vëren se, për kuptimin e përgjithshëm të mjeteve të provave i referohet parashikimeve të nenit 80, të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar, i cili kuptohet si jo kufizues lidhur me mjetet e provës për palët. Në këtë kuptim, pala mund të paraqesë para organit publik, çfarëdo lloj prove për të provuar se ka të drejtë gjatë vlerësimit të rrethanave të çështjes, përfshirë edhe fotot, të cilat janë çmuar nga Komisioneri në raport e harmoni me provat e rrethanat e tjera të çështjes.

Provat mund të jenë të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta. Në rastin e parë, provat çojnë drejt fakteve vendimtare, dhe në rastin e dytë, çojnë në fakte të cilat mund të shërbejnë si baza për arritjen e një përfundimi lidhur me një fakt vendimtar. Në këtë logjikë, rasti i dytë lidhet me pretendime që nuk faktohen vetëm me dokumenta me shkrim, por kanë të bëjnë me çdo material që është i përshtatshëm për të vërtetuar fakte apo për të konfirmuar deklaratat, të tilla siç mund të jenë dhe fotografitë.

Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit.

Bazuar në publikimet e ndryshme, si ato të shtypit të shkruar apo dhe ato të bëra në rrjetin social facebook, në faqen personale të B. P, evidentohen qartazi bindjet dhe angazhimi politik i tij, si pjesë e strukturave të PS. Kështu, në jetëshkrimin e tij, evidentohen, ndër të tjera se:

- Në vitet 2000-2005 ka qenë Nënprefekt i Mirditës;
- Në vitet 2012-2013 ka mbajtur pozicionin e nënkryetarit të Bashkisë Rrëshen gjatë periudhës kur kryetar i saj ishte N. D, përfaqësues i PS;
- Ka qenë një nga kandidaturat për kryetar të Bashkisë Rrëshen, për subjektin politik të PS, së bashku me N. D.
- Ka qenë anëtar i Këshillit të Rrethit Mirditë si dhe anëtar i Këshillit Bashkiak Mirditë, për subjektin politik të PS.

---

<sup>25</sup> <https://m.facebook.com/bardhok.pulaj>

<https://www.facebook.com/bardhok.pulaj/posts/3852186754898378>

<https://www.facebook.com/bardhok.pulaj/posts/3983694511747601>

<https://www.balkanweb.com/mas-e-paditi-per-pjesemarrje-ne-fushate-kreu-i-zyres-arsimore-ne-lezhe-te-jesh-socialist-seshte-krim/>

<http://www.arkivalajmeve.com/Rama-ne-Rreshen-Ta-fitojme-edhe-kete-Bashki.1047005041/>

[https://m.facebook.com/104554897934179/posts/158603519195983/?refsrc=deprecated&\\_rdr](https://m.facebook.com/104554897934179/posts/158603519195983/?refsrc=deprecated&_rdr)

[https://m.facebook.com/104554897934179/posts/158603519195983/?refsrc=deprecated&\\_rdr](https://m.facebook.com/104554897934179/posts/158603519195983/?refsrc=deprecated&_rdr)

VKM nr. 99, datë 27.02.2019 *“Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”*, në pikën 14, të saj ka përcaktuar se: *“Drejtorët e drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar emërohen dhe lirohen nga ministri”*.

Bazuar në sa më lart, Komisioneri evidenton faktin se për sa kohë drejtorët e DRAP emërohen dhe lirohen nga vetë ministri, i cili është një funksion i mirëfilltë politik, nuk mund të mos merret në konsideratë edhe ndikimi politik i emërimeve të bëra prej tij.

Bazuar në publikimet e faqes zyrtare të Bashkisë Shkodër<sup>26</sup>, lidhur me aktivitetin politik të B. N (Drejtore e ZVAP Shkodër) evidentohet se kjo e fundit, ka qenë anëtare e Këshillit Bashkiak, e listuar me numrin rendor 03, si propozim i subjektit politik PS.

Po ashtu, bazuar në publikimet e faqes zyrtare të subjektit politik PS<sup>27</sup> rezultojnë të provuara bindjet politike të B. N, si pjesë e strukturave dhe Asamblesë së PS.

Kodi i Procedurës Administrative, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: *“Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme”*.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, nga ana e subjektit ankues, atë të mospasjes së *“bindjeve politike”*, në ndryshim nga E. Rr, e cila ka të njëjtat bindje politike me B. N (drejtore në detyrë e ZVAP Shkodër, deri në muajin qershor 2021) dhe B. P (drejtori i DRAP Lezhë), të cilët i kanë të ekspozuara haptazi bindjet e tyre politike si përkrahës, aktivistë dhe pjesë e strukturave politike të subjektit politik PS.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.**

Në pikën A.1 të Vendimit, Komisioneri ka vlerësuar se, bazuar në kompetencat e sanksionuara nga ligji nr. 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, *gëzon legjitimitet pasiv në këtë proces DRAP Lezhë, pasi ajo gëzon tagrin për emërimin e drejtorëve të IPAP*. Në këtë kontekst, Komisioneri, ka trajtuar pretendimin e ankueses për diskriminim kundrejt këtij subjekti.

Kushtetuta është akti më i lartë juridik, ligji më i lartë (lex superior), në pajtueshmëri me të cilin duhet të jenë të gjitha aktet e tjera juridike.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë

---

<sup>26</sup> <http://cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202019/KANDIDATE%20PER%20KESHILLTARE%20BASHKIE/BASHKIA%20SHKODER/PS/03.BLEDIANE%20NIKA/PS-03-SHKODER-CV-BLEDIANE%20NIKA.pdf>

<sup>27</sup> <https://ps.al/familja-jone/b-h-nika>

shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*.

Doktrina kushtetuese, e trajton të drejtën e individit për punë në një kontekst të gjerë, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e tij për kualifikime profesionale dhe për të bërë karrierë, duke theksuar se liria për punë mbrohet nga rregullimet kushtetuese.<sup>28</sup>

Gjykata Kushtetuese<sup>29</sup>, ka mbajtur qëndrimin se: *“E drejta për punë, që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, përbën një të drejtë të individit, e drejtë e cila...fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi.*

*Garancia që Kushtetuta i jep individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit ka si qëllim mbrojtjen e lirisë së veprimit nga kufizimet e papërligjura të shtetit.*

*Liria e profesionit duhet kuptuar vetëm si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që neni 49 i Kushtetutës i bën të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë”.*

Në rastin në fjalë kemi të bëjmë me situatën kur mund të lindë një marrëdhënie pune midis shtetit (DRAP Lezhë) dhe individit (ankueses), e cila normohet nga rregullimet specifike ligjore. E drejta e individit për punësim përfshin edhe kushtet dhe rrethanat në të cilat ai vendoset edhe gjate shpalljes së vendeve të lira të punës.

LMD, në nenin 12, “Ndalimi i diskriminimit në punësim”, pika 1, shkronja a) e tij, ka përcaktuar se:

*“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës...”*

Parimi i mosdiskriminimit, parashikohet edhe në Kodin e Punës, i cili në pikën 1, të nenit 9, të tij ka përcaktuar se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë*

<sup>28</sup> Livio Paladini, “Diritto Costituzionale”, CEDAM, Padova, 1991, fq. 166-175.

<sup>29</sup> Vendimi nr. 20, datë 11.07.2006, i GJK.

*diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”.*

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, “*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shoqëruese shkaqesh.

Ndërkohë Protokollit 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar:

*“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;*

*b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;*

*c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;*

*d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte, në të cilën përfshihet dhe e drejta e individit për t’u ngritur në karrierë, parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

*“Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore<sup>30</sup>”, i cili sanksionon të drejtën për punë në nenin 6, të tij. Sipas këtij akti ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut, i cili është ratifikuar nga vendi ynë, parashikohet se, e drejta për punë përfshin të drejtën e secilit për të pasur mundësinë e sigurimit të jetesës, rritjes profesionale dhe mundësisë për të bërë karrierë, duke punuar punën e pranuar lirisht dhe marrjen e masave të përshtatshme për ta mbrojtur këtë të drejtë. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim.*

Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>31</sup> *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi.

Konventa e përkufizon diskriminimin si - *çdo dallim tjetër*, përjashtim ose preferencë që çon në prishjen apo shtrembërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose të profesionit.

---

<sup>30</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

<sup>31</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

*Karta Sociale Europiane*<sup>32</sup> në nenin 1, pika 2, parashikon: “ Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...”

Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim<sup>33</sup>.

Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane, ku përcaktohet shprehimisht mbrojtja nga diskriminimi për cilindo nga shkaqet e mbrojtura.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin, parime të cilat janë të ndërlidhura.

Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme<sup>34</sup>.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si, çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është edhe “*diskriminim strukturor*”, i cili përkufizohet nga neni 3, pika 6, si një formë diskriminimi që u referohet rregullave, normave, praktikave, modeleve të qëndrimeve dhe sjelljeve në institucione dhe në struktura të tjera shoqërore, që në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme paraqesin pengesa për grupet ose individët për të pasur të njëjta të drejta dhe mundësi si të tjerët dhe që kontribuojnë në rezultate më pak të favorshme për ta në raport me të tjerët.

Bazuar në nenin 9/1, të Kodit të Punës, dhe ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi, ndalohet çdo formë diskriminimi në ushtrimin e të drejtës për punësim dhe profesion.

Në bazë të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në jurisprudencën e saj ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të

<sup>32</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 8960, date 24.10.2002.

<sup>33</sup> Shih: *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, prg 30.

<sup>34</sup> Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t'i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS<sup>35</sup> gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

Në nenin 9, pika 10, të Kodit të Punës, parashikohet se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”*.

Bazuar në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Neni 33, pika 7/1 e LMD, ka parashikuar se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”*.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se nuk ka trajtim të ndryshëm, apo se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, subjekti ankues duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

---

<sup>35</sup> Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të padrejtë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse DRAP Lezhë, që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.<sup>36</sup>

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është bazuar pikërisht në standartin e mësipërm të të provuarit, gjatë shqyrtimit dhe konkluzioneve të arritura, në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në analizë sa më sipër Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit kundrejt ankuses nga DRAP Lezhë, dhe si pasojë barra e provës bie tek ky i fundit. Në këto kushte, DRAP Lezhë duhet të argumentojë e provojë të kundërtën, pra ekzistencën e njërit nga dy kushtet e përmendura më sipër.

Bazuar në konkluzionet e pjesës A.2, të Vendimit, Komisioneri konkludoi se, subjekti ankues është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm krahasuar me përcaktimet ligjore dhe standartin e krijuar për emërimin e drejtorëve të IPAP, nga ana e DRAP Lezhë, përse i takon procedurës së ndjekur për emërimin e drejtorit të IPAP “Pashko Vasa” Shkodër.

Njëkohësisht sa më sipër, rezultuan të provuara si deklaratimet e ankuses për mospasje të bindjeve politike dhe mos angazhim të saj në asnjë strukturë apo forcë politike, dhe po ashtu, rezultuan të provuara bindjet politike dhe angazhimi politik nëpër aktivitete të PS, për drejtoreshën e emëruar të IPAP “Pashko Vasa” Shkodër, drejtoreshën e ZVAP Shkodër dhe drejtorin e DRAP Lezhë.

Bazuar në aktet e administruara dhe konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, në pamje të parë, pra *prima facie*, faktet dhe provat e administruara krijojnë prezumimin se, ankuesja mund të jetë trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme, me E. Rr, gjatë procedurave të ndjekura nga DRAP Lezhë, nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të saj, për shkak të mos pasjes së bindjeve apo një angazhimi politik të saj në dhe me strukturat e PS.

Në këto kushte DRAP Lezhë, kishte barrën e provës që të provonte, ose që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm, ose duke provuar se megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimet e ankuses se këto veprime janë kryer për motive politike.

Për trajtimin diskriminues në pjesën dërrmuese të çështjeve nuk ekzistojnë prova të drejtpërdrejta. Bindjet politike (*përfshirë dhe mospasja apo mosdeklarimi i tyre, sipas elaborimit të bërë më lart*) përbëjnë një të dhënë sensitive të personit dhe shpesh herë subjekti kundër të cilit paraqitet ankesa,

---

<sup>36</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

mbrohet me faktin se ai e ka të ndaluar që të mbledhë të dhëna për bindjet politike të punonjëve që ka apo mund të ketë në varësi të tij, e për rrjedhojë ai nuk ka si të ketë dijeni për bindjet politike të tyre.

Në lidhje me këtë moment, Komisioneri vlerëson se, provat e tërthorta mund të hedhin poshtë pretendimin e subjektit/punëdhënësit të supozuar, se nuk ka patur dijeni për bindjet politike të punonjësit dhe për këtë arsye të provohet se punëdhënësi ka patur dijeni.

*Dijenja e DRAP Lezhë për bindjet dhe angazhimin politik të E. Rr, fakt për të cilin është favorizuar krahasuar me ankuesen, e cila është disfavorizuar pikërisht për shkak të mos pasjes angazhim politik, rezultojnë të provuara nga këto fakte:*

- Drejtuesi i DRAP Lezhë B. P, drejtuesja e ZVAP Shkodër B. N, si dhe kandidatja e emëruar drejtore e shkollës 9-vjeçare “Pashko Vasa” Shkodër E. Rr, janë në vartësi hierarkike institucionale përsa i përket marrëdhënieve të punës dhe përsa i përket bindjeve, angazhimit qytetar e politik i përkasin forcës politike që qeveris vendin.
- Siç dhe është shtjelluar në vendim, ky angazhim politik dhe elektoral (*citojmë zgjedhjet parlamentare të 25 prillit 2021*) nga të sipërpërmendurit është i njohur dhe i ekspozuar publikisht.
- Kështu, E. Rr. ka qenë pjesëmarrëse koherente si para dhe pas emërimit si drejtore, në aktivitetet elektorale të zhvilluara dhe publikuara nga drejtuesi politik i PS për Qarkun e Shkodrës I. B.
- Këto fakte, të lidhura edhe me momentet që kanë shoqëruar procedurën e tejzgjatur, me shtyrje, pezullime, shpalljen tre herë të vakancës, në shkelje të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 “*Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar*”, mungesa e shpjegimeve të arsyeshme nga DRAP Lezhë, për veprimet e kryera; krijojnë bindjen se favorizimi që i është bërë E. Rr, dhe disfavorizimi dhe trajtimi i pabarabartë i ankuses, janë ndikuar dukshëm nga motive të përkatësisë dhe angazhimit politik e partiak.

Në Strategjinë Kombëtare Arsimit 2021-2026<sup>37</sup> për MASR, teksa vlerësohet se<sup>38</sup>: “...prej vitit 2012 zbatohet një procedurë më transparente për rekrutimin e drejtorit të shkollës...”, pohohet dhe evidentohet fakti se: “...vendimi final (për emërimin e drejtorëve të shkollave) merret nga drejtori i DRAP dhe se kjo shihet si mundësi për ndërhyrje politike”.

Diskriminimi për shkak të bindjeve politike ndeshet më së shumti në çështjet që kanë të bëjnë me fushën e punësimit, marrëdhënieve të krijuara mes palëve, për shkak të përcaktimit të caktuar politik, në mundësinë për avancim në karrierë, varësisht nga përkatësia politike, etj.

---

<sup>37</sup> [http://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Strategji\\_APU\\_dokumenti\\_perfundimtar\\_24\\_03\\_2015.pdf](http://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Strategji_APU_dokumenti_perfundimtar_24_03_2015.pdf)

<sup>38</sup> Fq 53 e këtij dokumenti.

Sjellja dhe trajtimi diskriminues, gjithashtu, është çdo sjellje aktive ose pasive ndaj çdo personi nga ana e pushtetit, si dhe nga ana e personave fizikë dhe juridikë të sektorit privat dhe publik në jetën publike, që krijon baza për privilegjimin ose mosprivilegjimin e ndonjë personi në mënyrë të paarsyeshme, ose kur e ekspozon në sjellje të padrejtë degraduese në krahasim me persona të tjerë në situatë të ngjashme, që mbështetet mbi çdo bazë diskriminuese.

Mosdiskriminimi është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t'u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet. Kjo e drejtë është sanksionuar dhe mbrohet edhe me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Për të qenë përpara një veprimi diskriminues në kuptim të këtij ligji, Komisioneri vlerëson se, duhet të plotësohen tre kushte njëherësh:

- Të ekzistojë trajtimi i diferencuar i ankuesit në raport me të tjerët në kushte, rrethana të njëjta apo të ngjashme;
- Trajtimi i diferencuar të ketë ndodhur për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1, të këtij ligji;
- Trajtimi i diferencuar të ketë sjellë si pasojë vështirësinë apo pamundësinë e ankuesit për të ushtruar të drejtat dhe liritë e njohura nga kushtetuta, aktet ndërkombëtare të ratifikuara apo ligjet e tjera në fuqi.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri vlerëson se, në rastin e subjektit ankues përmbushen të tre këto kushte njëherësh dhe se, trajtimi i padrejtë, i pabarabartë dhe i disfavorshëm i ankueses, nuk ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

**Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se DRAP Lezhë, me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka diskriminuar ankuesen në të drejtën e saj për punësim, gjatë shpalljes së pozicionit të lirë për drejtor të shkollës 9-vjeçare “Pashko Vasa” Shkodër, përsa i takon procedurës së ndjekur për emërimin e drejtorit të kësaj IPAP.**

Për rrjedhojë DRAP Lezhë ka shkelur dispozitat e ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, respektivisht: nenin 3, pikat 1 dhe 6, dhe nenin 12, pika 1, shkronja a), të tij.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”*.

Në nenin 33, pika 12, të LMD-së, përcaktohet se: *“Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”*

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar si pasojë e vlerësimit të gabuar në përlllogaritjen e pikëve të dosjeve të

kandidatëve për drejtor të IPAP “Pashko Vasa” Shkodër, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur të ankueses duke i dhënë mundësinë asaj të kandidojë pranë DRAP Lezhë, si njëra ndër dy kandidatet me më shumë pikë.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 1, nenin 3, pikat 1 dhe 6, nenin 7, nenin 12, pika 1, germa a), nenin 13, pika 1, germa a), nenin 32, germa a), si dhe nenin 33, pikat 7/1, 10, 11 dhe 12, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të ankueses A. L, për shkak të bindjeve politike, nga ana e DRAP Lezhë.
2. Në referim të pikës 1, DRAP Lezhë, të marrë masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur të ankueses.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, DRAP Lezhë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha: Punësim  
Shkaku: Bindjet politike  
Lloji i vendimit: Diskriminim